



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Procesverbal nga mbledhja e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal, e cila u mbajt më datë: 06.02.2025 te “Joni Ranch” dhe filloj në ora 11:10. Në mbledhje të pranishëm ishin edhe drejtori për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Uran Berisha, Përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat Hysen Jerliu, përfaqësues nga drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, disa nga anëtarët e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Lokal si dhe disa përfaqësues të bizneseve lokale.

Rend Dite:

1. Plani buxhetor, plani vjetor i investimeve kapitale dhe progresi në realizimin e strategjisë zhvillimore,
2. Masat stimuluese të qytetit/komunës për ekonominë/bujqësinë dhe punësimin, nëse ekzistojnë,
3. Tarifat dhe taksat administrative dhe komunale, në fazën e planifikimit,
4. Çmimet dhe cilësia e shërbimeve komunale,
5. Mbrojtjen e mjedisit dhe mundësitë për një ekonomi të gjelbër,
6. Të ndryshme.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik- po fillojmë me takimin e sotëm, kemi edhe një propozim për rend dite si pikë e gjashtë e rendit të ditës, fjala është për Ndërtimi i qendrës së kompostimit, kush është që kjo të hyjë në rend dite. Për u deklaruan të gjithë.

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, sot ju kemi ftuar në këtë takim me dy tema, njëra është Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Lokal, ku drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, jep informata për pesë pikat e para.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë, ky komitet ka mbajtur edhe mbledhje të mëhershme, sot pikat e diskutimit i keni edhe para vete, sa i përket pikës së parë, Plani buxhetor, plani vjetor i investimeve kapitale dhe

progresi në realizimin e strategjisë zhvillimore, mund të ju njoftoj se në vitin 2025 drejtorja e jonë ka disa projekte investime kapitale, të cilat mendon me i realizuar e një ndër to është edhe bujtinat kthimi i objekteve komunale të cilat janë të pashfrytëzuara në viset malore, ato planifikohen të renovohen dhe të kthehen në bujtina. Fillimisht janë planifikuar tri objekte, pas përfundimit nga komuna ju mund të jepni mendimet e juaja se si të menaxhohen dhe si të funksionalizohen në mënyrën më të mirë që i shërbejnë edhe komunitetit por edhe bizneseve lokale. Në planifikim e kemi këtë vit, buxheti është i ndarë, pastaj qështja është tek funksionalizimi dhe menaxhimi.

Selmon Kastrati-cilat do të jenë lokacionet për këto bujtina?

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik- Kranidell, Feriqevë edhe Desivojcë., këto objekte ishin shkolla, tani janë të pashfrytëzuara ideja është që ato me i rinovuar me i adaptuar dhe me i kthyer në bujtina.

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, ne i kemi me i hedh në ankand publik, kemi bërë dy projekte në Feriqevë dhe Kranide, dhe projektin e Desivojcës e kemi gati. Ne i kemi këto ide, por ju nëse keni ide më të mira mund të tregoni. Investimi e bënë komuna, por edhe pala private që është përfutuese, ideja është me funksionalizuar për turizëm rural.

Fikrije Kastrati-Kranidelli dhe Desivojca janë shumë afër me Kamenicën, do të ishte mirë të jetë Lisocka, pasi që edhe kjo e ka shkollën edhe ky është një vend që mund të jetë funksional.

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-nëse ka të qytetar të interesuar me investime komplet të tij edhe ajo do të jepet një shfrytëzim, por komuna ka ndarë buxhet vetëm për tri shkolla me interevenuar vetë, ndërsa ata që kanë interes me marrë nuk është e kufizuar për me marrë në shfrytëzim në bazë të negocimit me kryetarin dhe miratimin në kuvend.

Fikrije Kastrati- mendova të jetë ky lokacion paqi që Kranidelli dhe Desivojca janë afër, ndërsa Lisocka është një vend më i largët. A mundemi ne të flasim me ndonjë biznesmen dhe komuna me ja lejuar?

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- në Lisockë ishte më e kushtueshme dhe komuna e jonë nuk e kishte buxhetin e duhur për këtë zonë, pasi që donë më shumë investim. Nëse ka interes dikush dorëzon biznes planin në komunë dhe shohim mundësit tjera. Rezultatën për pronë sa mund të arrin me kryetarin dhe votimin në kuvend ne nuk mundemi me parapa, por nëse ideja është që projekti me qenë zhvillimor , me hap vende pune, me zhvilluar turizëm gjithçka është e mundur.

Selmoni- a janë të përcaktuar objektet se çka do të bëhet apo e përcakton këtë pronari që do ta marrë këtë objekt?

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-ajo aktualisht është objekt arsimor, mirëpo me planin e ri zhvillimor komunal, ne i kemi hekë dhe e kemi lënë për zhvillim turizmit rural. PZHK-ja shumë shpejt do të bëhet aktual. Por nuk ka shumë problem, ndërrimi i destinimit të saj, ngase aty nuk ka më nxënës, por për turizëm rural për një vikend në vizitë i ndihmon ekonomisë dhe nuk është që mund të i pengoj diçka shtetit.

Shumsi Dodaj, si bujtinë do të bëhet nga ai person që e përfiton ankandin dhe ai person e lëshon me qera apo si do të ecë procedura.. Për sa kohë e merr në shfrytëzim këtë objekt?

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-objektin nuk mund të marrë përgjithmonë, kontrata më e gjatë është ajo 99 vjeçare, besoj që do të jenë mjaftueshëm të gjata kontratat për me i motivuar palët. Ideja është me dhënë kontrata afatshkurtër dhe me i parë investimet.

Halil Zylfiu-për bizneset ekzistuese a ka ndonjë ndihmë , shembull kanalizimi në Kitkë?

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- sa i përket kanalizimi është pak problem se është larg Kitka dhe nuk ka ku derdhen ato kanalizime. Shembull ka diku 50 km për me lidhën me kanalizimin më të afërt. Ai është investim kapital dhe për me bërë investime kapitale, komuna duhet me bërë planifikimin e projekteve shembull në vitin 2024 për vitin 2025, bëhet planifikimi. Tani kjo kërkesë e juaja po bëhet këtë vit dhe kjo nuk ka mundësi të realizohet në vitin 2025 dhe nuk mund të realizohet para vitit 2026-të.

Hysen Jerliu-përfaqësues nga drejtorja e Shërbimeve Publike, ka mundësi me ndonjë projekt me ministrinë e linjës se vetë komuna e ka të vështirë me realizuar një projekt të tillë i cili mund të kushtojë diku 1 milion euro, ngase komuna nuk ka kapacitet.

2. Masat stimuluese të qytetit/komunës për ekonominë/bujqësinë dhe punësimin, nëse ekzistojnë,

Qëndresa Kastrati- Zyrtares për zhvillim ekonomik-si komunë masa stimuluese për biznese japim grande për biznese të vogla dhe të mesme, hapim thirrje publike ku në një formë prej vitit të kaluar ka qenë një fond prej 100 mijë euro ku është hap për biznese të vogla dhe të mesme në formë të grandeve. Grandet janë ndarë në formë të pajisjeve por jo për infrastrukturë që ishte kërkesa e z. Halil që e paraqiti për kanalizimin ne grande japim për pajisje që ju kryen punë bizneseve. Është një ndër masat stimuluese që ne e përdorim.

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- edhe si projekt që jep kryetari dhe ku ka mundësi me marr pjesë me 50%, e bënë një projekt konsultohu me ndonjë inxhinier dhe nëse mund të flasësh me kryetarin mund të hysh në rend pa pritur planifikimin e 1 vjeçarit.

Femi Dold-ka disa investime që kanë kosto më të madhe, shembull rryma ka një kosto të madhe e që nuk kemi ndihmë nga askush edhe këto janë probleme që po na paraqiten. Kam restorantin në Bujnovc ku kam disa bujtina por infrastruktura është zero.

Hysen Jerliu-përfaqësues nga drejtorja e Shërbimeve Publike- ju e dini se probleme ka pasën edhe me Kika Hill për asfaltimin e rrugës po ashtu është kërkuar që të vendoset një trafo ngase nuk ka kapacitete aty, por kur të vinë kërkesa tek ne, ne nuk mund të japim leje për prona private. Biznesi në këtë rast duhet të zgjedh problemin me banorë.

Uran Berisha- Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- rruga e kitkës qe 4 vite nuk është asfaltuar shkaku i 2-3 banorëve.

3. Tarifat dhe taksat administrative dhe komunale, në fazën e planifikimit,

Qëndresa Kastrati- Zyrtares për zhvillim ekonomik- ju e dini se bizneset taksohen edhe përmes komunës varësisht nga veprimtaria edhe disa kushteve që i kemi rregulluar nga rregullorja për ngarkesa, taksa dhe tarifa, kisha dashtë nga ju të kemi ndonjë sugjerim se si i shihni ju këto taksa që janë kryesisht për biznese?

Shumsi Doda- është mirë që na me i paguar taksat e ju me na këmbyer neve.

Halili-taksat është mirë me shkuar në emër të biznesit me metër katror të hapësirës. Shembull unë kam taksë komunale 200 euro e që kam në shfrytëzim 36m², me këto metra katror mendoj se ngarkesa është pak e madhe, sezonin e kam mars-qershor.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik- kur është bërë rregullorja për ngarkesa, taksa e kemi marrë parasysh edhe qarkullimin vjetor të biznesit e jo vetëm hapësirën. Po ashtu ndarja është edhe në bazë të veprimtarisë, prodhuesit janë të liruar nga taksat. Bizneset që kanë pronare femra janë të liruar në periudhë prej dy vite. Ne propozimet e juaja mund ti marrim, ngase ajo rregullore mund të plotësohet, ndryshohet. Nëse propozimet vinë shembull siç është komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik, ose nga një grup i bizneseve, mbledhen së bashku të gjitha propozimet, pastaj mund të sillen propozimet dhe të plotësohet-ndryshohet kjo rregullore.

Halili-bizneset ndërrohen, shembull artari mund të i ketë 5m², por ndonjë artar tjetër i ka 50m, nuk mund të llogarit si “Viva Fresh” që ka një hapësirë kaq të madhe, sikur “Besa Center” e “Driloni”, shembull “Agro Unioni” ka 5 ha/depo, unë i kam 36m², shkon me veprimtari të njëjtë ngarkesa e njëjtë.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik-kjo ndërlidhet edhe me qarkullimin e biznesit, nëse ke hapësirë më pak edhe qarkullimi është më pak, ata që kanë hapësirë më të madhe kanë edhe qarkullim më të madh.

Uran Berisha-Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, me poentu përqindjen e taksës kush e përbënë, faqja e ambientit ku ai vepron, qarkullimi, hapësira në shfrytëzim, parkingu.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik- nëse keni diçka për çmimet, shërbimet komunale dhe çfarë do lloj shërbimi jo vetëm për biznese.

Shumsi Dodaj- Shërbime e mbeturinave janë tani shumë më të mira.

Qëndresa Kastrati- Zyrtare për zhvillim ekonomik- tani janë edhe disa shërbime që ofrohen edhe përmes kompanisë që është themeluar tani, tani ajo shkon edhe në zgjerim të shërbimeve.

Halili-kish propozuar kontrolla më shumë rrugëve, shembull deri tek qafa e Kopërnicsë pastrohet, si të dalsh në qafë të Kopërnicsë ke shumë mbeturina, është mirë të vendoset një kamerë dhe të shikohet se kush po hedh mbeturina.

Hysen Jerliu-përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektoriati, ne duhet me i kuptuar mbeturinat e shtëpisë me atë materiale të ngurta. Ekonomitë familjare del që 86.2 e kemi mbulues mërinë, ne nuk mund të shkojmë 100% pasi që po e mari shembull

Dazhnicën nuk mund të dali kamioni. Mund të them se nuk është mënyrë e pakënaqur, dhe jemi duke u munduar me bërë zgjerimin, po ashtu jemi duke u munduar me bërë lokacion për hedhjen e mbeturinave të ngurta. Një vend do të jetë ka Dajkovci dhe një tjetër ka rruga e Moçarit. Kemi edhe me Plan Zhvillimor të parapamë se edhe aty duhet një kosto dhe vendet e caktuara se ku do të hedhen mbeturinat.

Shumsi Dodaj- masi të hodhën mbeturinat e ngurta në këto vende, çka bëhet kur të mbushen ato vende me mbeturina të ngurta?

Uran Berisha-Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-plan e kemi me bërë një qendër për trajtimin e tyre me i bluar ato dhe me krijuar për me i shtruar rrugët e malësisë.

6. Qendra e Kompostimit


Qëndresa Kastrati- Zyrtares për zhvillim ekonomik- pikën e katërt dhe pikën e pestë do ta diskutojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Uran Berisha-Drejtor për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- Do të ja shpjegoj qendrën e kompostimit kemi fituar një grand prej Sllovenëve 700 mijë euro ku një pjesë të tyre e kemi investim tonin që na ka ndarë ministria parat. Do të ndërtohet një qendër për trajtimin e mbeturinave organike, mbeturinat që teprojnë prej restoranteve, prodhuesve të pemëve, rrënjë etj që janë organike, me i bluar dhe me i shndërruar në dhe organik. Në kuadër të projektit e kemi edhe makinerinë për paketimin e thasëve. Për momentin këtë do ta marrë ndërmarrja publike “Dardana” me marrë nën menaxhim, janë diku mbi 400 mijë euro makineri, janë dy traktorë, një traktor kushton 220 mijë euro që është 4x4, janë rimorkio të thella dhe një traktor tjetër që bënë rrotullimin . Dje kryetari e ka nënshkruar marrëveshjen me ministrinë për 200 mijë euro që ka me na dhënë për këtë projekt, sllovenët diku mbi 400 mijë euro, financat janë siguruar. Projekti i ka 200 kontejnerë 50 janë nga 240 L, që do të ja shpërndajmë bizneseve me dhënë produktin organik që ju tepron shembull prodhuesi i mollëve mund të na japë lëvoret, pishat që kalben, pluhur ato të gjitha krasitja e arrave etj. Ka makineri për bluarjen e degëve për momentin do të marrë ndërmarrja publike në dardanë, pastaj do të shqyrtohet mundësia për dikush që është i interesum me e marrë kontejnerë do të shpërndahen për ata që kanë të interesuar me ju ndarë mbeturinat organike prej letrës e plastikës do të ndahen e do të sjellën në shtëpi janë 150 që do të shpërndahen fillimisht me këtë projekt. 50 janë kontejnerë më të mëdhenjtë dhe atyre bizneseve që ju duhen kontejnerët do të marrin dhe është kamioni i cili do të shkojë të i mbledh nëpër biznese. Projekti është 700 mijë euro, makineritë janë diku mbi 400 mijë euro, për këtë projekt. Drejtori edhe në mënyrë grafike edhe pajisjet që do të jenë për këtë projekt makina rrotulluese, të cilat për 30 ditë gjithçka shndërrohet në dhe. Një lloj tjetër është rrotullues për me klasifikuar granulatet e ndryshme, pluhuri është kualitet më i lartë që shitet më shtrenjtë, ndërsa ai që i ka kokrrat më të mëdha është tjetër kualitete etj. Ne do t'i mbajmë edhe 4 dëgjime publike. Ky projekt ndikon drejtpërdrejt në mbrojtje të ambientit dhe në ekonominë qarkore që deri tani nuk kemi pasur projekte të tilla.


Qëndresa Kastrati- Zyrtares për zhvillim ekonomik- nëse nuk keni pyetje të tjera do ta shpallim të mbyllur këtë takim.

Takimi u përmbyll në ora 12:00.

Procesmbajtëse:


Sabile Arifi

Kryesuese e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal


Albana Ajvazi